



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 19

Tiranë – E martë, 19 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11073, datë 11.2.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 657
Dekret i Presidentit nr. 11074, datë 11.2.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 657
Dekret i Presidentit nr. 11078, datë 11.2.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 658
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 13.2.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar..... 658
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 61, datë 13.2.2019	Për emërim në detyrë..... 659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 62, datë 13.2.2019	Për emërim në detyrë..... 659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 13.2.2019	Për lirim nga detyra..... 659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 13.2.2019	Për miratimin e Planit të Veprimit të Reformave të Investimeve 2019–2020..... 659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 65, datë 13.2.2019	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale..... 680
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 13.2.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 789, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të certifikimit për profesionistët e shëndetësisë”..... 700
□	□
□	□

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 13.2.2019	Për miratimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.....	700
Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.2.2019	Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.....	701
Vendim qarkullues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 3, datë 13.2.2019	Për anëtarësimin e shoqërisë së kursim-kreditit “Tirana Invest Kredit 2000”, në skemën e sigurimit të depozitave dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave.....	705
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2176/2 datë 19.2.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër Këlcyrë”.....	705
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2177/2 datë 19.2.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruksioni i rrugës ‘Jakov Mile’, segmenti II, lagjja ‘Apollonia’”, Fier.....	708
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2178/2 datë 19.2.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtim, asfaltim i rrugës Cërrik – Belsh – Dragot – Kuçovë – Ura Vajgurore”.....	709
	Kërkesë për konfirmimin e vdekjes së shtetasës Aishe Kovaçi.....	709
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Muhamet Virjoni.....	709

**DEKRET****Nr. 11073, datë 11.2.2019****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Albert Osman Aldedja
2. Myzafer Ismail Koçi
3. Florina Shaban Rexha
4. Gëzarta Mustafa Kuçi
5. Orland Mevlud Rrushi
6. Ndrçime (Ndricime) Sherif Sulaj (Dani)
7. Astrit Ibrahim Biba
8. Doruntina Arben Qitaku
9. Agnes Dinush Veizaj
10. Thoma (Thomas) Vasillaq Harisi (Charisis)
11. Ava Bardhyl Shkëmbi
12. Gentjan Xhemal Demuçaj (Demuçaj)
13. Jetë (Jete) Fasli Schmerler (Sala)
14. Mirela Ded Gjoka (Vuçaj/Vuçaj)
15. Klajdi Kolë Gjoka
16. Momir Stojan Zllatiçanin (Zllaticanin/ Zllatiçanin/ Kerstoja)
17. Bledar Dervish Smaja
18. Sara Bledar Smaja
19. Suzana Servet Aliaj (Shuli)
20. Gledi Florenc Kutrolli
21. Enzo Fatmir Vata
22. Sevdie Maliq Ademaj (Duraku)
23. Kidi Adriatik Ademaj
24. Arber Pellumb Lamçe
25. Marah Arber Lamçe

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 11074, datë 11.2.2019****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozime edhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë e ministrit të Kulturës,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Qerim Imer Letaj
2. Arbërita Isa Letaj (Krasniqi)
3. Arianit Nexhmedin Shehu
4. Lumniye Kemal Shehu
5. Besnik Ramadan Berisha
6. Pleurat Osman Halili
7. Mëhrije Qazim Braha
8. Agron Shaban Krasniqi
9. Arian Xhemaletdin Agushi
10. Deepit Devinder Pal Singh
11. Ermir Agim Kryeziu
12. Shyhrete Qemail Salihu (Behluli)
13. Luan Hajdin Salihu
14. Muhamed Azem Krasniqi
15. Shemsidin Azem Krasniqi
16. Baton Ismet Arifi
17. Flora Shefqet Arifi (Berisha)
18. Majlinda Jakup Nushi Limani (Nushi)
19. Agon Jahja Kokaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**DEKRET****Nr. 11078, datë 11.2.2019****PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Aleksandër Fatos Zhibaj
2. Ines Bardhyl Shkëmbi
3. Nikokita Edmond Tusha
4. Stojan Gojko Zllaticanin (Kerstoja)
5. Gladiola Pavlo Draçini (Dhora)
6. Matilda Foto Koçi (Çulla)
7. Besmir Jani Dore
8. Ardian Vangjel Leko
9. Artur Koço Vjeteri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM**Nr. 60, datë 13.2.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 175, DATË 8.3.2017, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI
PAGË TË PUNONJËSVE MËSIMORË NË
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

Faqe | 658

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli i vendimit ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”.

b) Në paragrafin e parë të pikës 1, pas fjalëve “...mësuesit/edukatorët...” shtohen “...punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe punonjësit e tjerë jomësimorë që shërbejnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor ...”.

c) Në ndarjen me numrin rendor 15, të lidhjes nr. 1, që përmendet në pikën 2, të vendimit, emërtimi “psikolog shkolle” hiqet.

ç) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2.1. Struktura e pagës për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe punonjësit e tjerë jomësimorë në institucionet arsimore, sipas përcaktimit në pikën 1, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

d) Në pikat 3.a, 3.b dhe 3.ç, pas fjalëve “... e lidhjes nr. 1 ...”, shtohen “... dhe lidhjes nr. 1/1 ...”.

dh) Në fund të pikës 3.c) shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Shtesa për kualifikim (kolona 4 e lidhjes nr. 1/1), është 0.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë nga data 1 janar 2019 dhe të përballohen nga fondet e parashikuara për sistemin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe**



Lidhja nr. 1/1

Struktura e pagës për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe punonjësit e tjerë jomësiorë në institucionet e arsimit parauniversitar

	EMËRTIMI/POZICIONI	PAGA MUJORE			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
	1	2	3	4	5
1	Psikolog shkolle	1	2% e PG	0	42350
2	Oficer i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar	1	2% e PG	0	42350

VENDIM**Nr. 61, datë 13.2.2019****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Lorena Haxhiu emërohet zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

VENDIM**Nr. 62, datë 13.2.2019****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Redi Shtino emërohet zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

VENDIM**Nr. 63, datë 13.2.2019****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ilir Halilaj, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

VENDIM**Nr. 64, datë 13.2.2019**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
VEPRIMIT TË REFORMAVE TË
INVESTIMEVE 2019–2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e planit të veprimit të reformave të investimeve 2019–2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe



PLANI I VEPRIMIT I REFORMAVE TË INVESTIMEVE

2019–2020

Dhjetor 2018

HYRJE

Iniciativa për hartimin e Planit të Veprimit të Reformave të Investimeve (Investment Reform Action Plan-IRAP) për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë për periudhën 2019–2020 është ndërmarrë në kuadër të procesit të Berlinit (28 gusht 2014), i cili shërbeu si një urë mes Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, për të mbajtur gjallë “Dialogun politik integruar të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6)”.

Procesi i integritetit rajonal drejtohet nga koordinatorët kombëtarë të WB6, i materializuar me një Plan shumëvjeçar Veprimi për Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA), i miratuar në Samitin e Triestes (më 12 korrik 2017).

MAP REA paraqet një agjendë strategjike të përbashkët për ekonominë e WB, me synim rritjen e qëndrueshme ekonomike, krijimin e kushteve për një klimë investimi më të mirë, më transparente dhe konkurruese, duke u fokusuar në katër shtylla: tregtia, investimet, mobilitet dhe integritet digjital.

MAP REA në shtyllën e investimeve, obligon shtetet e WB6 të zhvillojnë Agjendën Rajonale të Reformës së Investimeve (RIRA- e miratuar më 11 maj 2018), i cili duhet të zbatohet nëpërmjet një Plani Veprimi të Reformave të Investimeve (IRAP).

Në takimin e Sherpave, më 20 nëntor 2018, Shqipëria raportoi për progresin e arritur për implementimin e Agjendës së Reformës së Investimeve Rajonale, ku Komisioni Evropian kërkoi që IRAP-së, të finalizohet e të miratohet brenda vitit 2018.

KUADRI I POLITIKAVE DHE VEPRIMET E REFORMAVE

Tabela e mëposhtme e veprimit të reformave paraqet një grup të detajuar të veprimeve të reformave të cilat do të zbatohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, përfshirë periudhën e zbatimit, agjencinë drejtuese, rezultatet e pritshme dhe mbështetjen e donatorëve që do të kërkohet për të arritur objektivat e përgjithshëm të përcaktuara nga Agjenda Rajonale e Reformës së Investimeve (RIRA). Planet vjetore të veprimit të detajuara do të përgatiten nga agjencitë përkatëse drejtuese për secilën nga veprimet e reformave.

Tabela e veprimit të reformave do të shqyrtohet dhe përditësohet sipas nevojës në bazë dyvjeçare nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë për të pasqyruar ecurinë lidhur me zbatimin dhe për të siguruar rëndësinë e vazhdueshme të veprimeve të reformave individuale, ku versioni i tanishëm i IRAP-së formon bazën për përditësimet në të ardhmen, sipas dhe sikurse përshkruhet nga secili veprim. Përditësimet do të pasqyrojnë në mënyrë specifike specifikimin e veprimeve të mëtejshme të reformave që Qeveria ndërmerr për të zbatuar, pas analitikës dhe diagnozës të përfunduar si pjesë e këtij plani të veprimit. Përditësimet do t'i njoftohen dialogut rajonal mbi politikën e investimeve, në kuadër të Grupit të Përbashkët të Punës mbi Investimet SEEIC-CEFTA.

Veprimet e qeverisë strukturoren përgjatë fushave të politikave dhe temave të reformës të përcaktuara në Agjendën Rajonale për Reformën e Investimeve (RIRA), përkatësisht: i) Hyrja dhe krijimi i investimeve; ii) Mbrojtja dhe ruajtja e investimeve; dhe iii) Tërheqja dhe nxitja e investimeve. Rezultatet paraqesin arritje konkrete të veprimeve specifike të qeverisë.



Fusha I e politikës. Hyrja dhe krijimi i investimeve

Çështja e reformës/ Angazhimi RIRA	Veprimet IRAP	Afati kohor	Agjencia drejtuese	Rezultatet	Mbështetja e donatorëve	Komente
<i>1. Rritja e mundësive të hyrjes dhe krijimit për investitorët</i>						
<i>1.1 Rishikoni ligjet dhe rregulloret e brendshme në WB6 për mospërputhjet me parimet e jodiskriminimit mbi hyrjen dhe vendosjen (analiza e mospërputhshmërisë të hyrjes) dhe publikoni një liste të konsoliduar të pengesave ligjore të hyrjes për rritjen e transparencës për investitorët.</i>	1.1.1 Parashtroi dhe hartoni instrumente ligjore për t'u shqyrtuar si pjesë e Analizës së Mospërputhshmërisë të Hyrjes	Qershor2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Lista e ligjeve dhe rregulloreve që prekin investimet në Shqipëri.	IFC/Grupi i Bankës Botërore Projekti Rajonal i Politikave dhe Nxitjes së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (GBB- BB-PNI)	<i>Objekti i mbulimit shtrihet në të gjitha ligjet dhe rregulloret që prekin investimet në nivel kombëtar, përfshirë instrumentet ligjore horizontale dhe specifike sektoriale.</i>
	1.1.2 Rishikoni dhe analizoni instrumente ligjorë të përzgjedhur paraprakisht, për të identifikuar masat që mund të shkelin parimet që përbëjnë objektin thelbësor të analizës	Dhjetor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Raporti përmban rezultatet e Analizës së Mospërputhshmërisë të Hyrjes Një listë e pengesave ligjore të hyrjes.	GBB (Grupi i Bankës Botërore) - BB (Banka Botërore) PNI (Politikat dhe Nxitja e Investimeve)	<i>Objekti thelbësor i analizës së këtij veprimi IRAP, si dhe formati i rezultateve përshkruhet në aneks. Analiza do të integrohet me procesin e vazhdueshëm të një Grupi Teknik Pune, për të shqyrtuar legjislacionin e përgjithshëm dhe sektorial që ndikon në investimet në Shqipëri, si pjesë e hartimit të "Ligjit të unifikuar të investimeve".</i>
	1.1.3. Publikoni një listë të konsoliduar të pengesave ligjore hyrëse të identifikuara në Veprimin IRAP 1.1.2.	Dhjetor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Publikimi i listës së pengesave ligjore të hyrjes të identifikuara në Veprimin 1.1.2 IRAP.	Nuk nevojitet	<i>Autoritetet shqiptare do të vendosin mbi strukturën e listës.</i>



1.2 Përdorni sa më sipër për të njoftuar mbi një diskutim mbi pengesat ekzistuese për investimet në rajonin WB6.	1.2.1. Bazuar në analizën e kryer në kuadër të Veprimit IRAP 1.1, vendosni nëse do të bëni përpjekjet për reforma në lidhje me hyrjen e investimeve.	Dhjetor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Vendimi nëse do të zbatohen veprimet e reformave.	Nuk nevojitet	Pas vendimit, autoritetet shqiptare do të përditësojnë këtë pjesë të IRAP në përputhje me rrethanat dhe do të specifikojnë/përsëruajnë më tej çdo përpjekje reformash që qeveria synon të ndërmarrë sipas veprimit IRAP 1.2.1.
--	--	--------------	------------------------------------	---	---------------	--

2. Përmirësimi i politikave dhe procedurave të krijimit të biznesit

Veprimet e reformës sipas nenit 2.1 më poshtë ndjekin dy rryma të veçanta të aktiviteteve. Veprimet e reformës 2.1.1. dhe 2.1.2 kanë të bëjnë me zhvillimin dhe forcimin e një portali rajonal për regjistrimin e biznesit për të lehtësuar regjistrimin e kompanisë në nivel rajonal - një nismë e mbështetur nga BERZH. Veprimet e reformës 2.1.3. deri 2.1.5. kanë të bëjnë me sigurimin e informacionit përkatës në lidhje me procedurat e krijimit dhe regjistrimit të biznesit përmes një platforme rajonale informacioni “Investoni në EJL”, që merret përsipër nga Forumi i Dhomës së Investimeve. Veprimet e Reformës sipas nenit 2.2 kanë të bëjnë me një rishikim dhe krabasim rajonal të procedurave të regjistrimit të biznesit dhe kërkesave për të informuar shtrirjen potenciale në nivel rajonal.

2.1 Mbështesni zhvillimin e një portali biznesi për katalogimin, sigurimin dhe krabasimin e informacionit mbi procedurat për krijimin dhe funksionimin e një biznesi në rajon, duke u bazuar në bashkëpunimin e filluar dhe tashmë ekzistues të agjencive të rajonit për regjistrimin e biznesit.	2.1.1 Plotësoni informacionin ekzistues në lidhje me procedurat e krijimit të biznesit në portalin rajonal për informacionin mbi biznesin “Investoni në EJL” ¹ , organizuar nga Forumi i Dhomave të Investimeve, duke hartuar procedurat për krijimin dhe funksionimin e një biznesi në Shqipëri dhe duke ofruar raportin që rezulton	June 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë/C IF	Një raport që liston dhe detajon procedurat e krijimit dhe të operimit të biznesit në Shqipëri për t’u përfshirë në Investime në portalin e EJL.	BERZH, GBB- BB-PNI sipas nevojës	Procedurat që duhet të përfshihen në “Investoni në EJL” si dhe informacioni i hollësishëm që duhet të jepet për secilën procedurë janë të listuar/përsëruar në Shtojcë. Investimi në portalin e EJL mbështetet financiarisht nga BERZH.
---	--	-----------	---	--	----------------------------------	--

¹ Portali është online dhe aksesohet në adresën <http://www.investinsee.com>



	2.1.2 Mbështesni mirëmbajtjen e portalit rajonal për informacionin mbi biznesin “Investoni në EJJ” duke caktuar një agjenci qeveritare përgjegjëse për të rishikuar dhe përditësuar periodikisht informacionin e dhënë në faqen e internetit.	June 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë/CIF	Një agjenci qeveritare e caktuar e autorizuar që të rishikojë dhe përditësojë periodikisht informacionet që jepen në portalin rajonal të informacionit të biznesit. Informacionet e përditësuara të ofruara në portalin rajonal të informacionit të biznesit në baza të rregullta.	Nuk nevojitet	<i>Qëllimi përfundimtar është nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet CIF dhe agjencisë qeveritare të caktuar që specifikon detajet e këtij bashkëpunimi.</i>
	2.1.3 Vazhdoni konsultimet e përbashkëta në lidhje me parimet dhe mekanizmat për funksionimin operacional të “Portalit Rajonal të Regjistrimit të Biznesit EJJ” dhe përfundoni krijimin e tij	Qershor 2020	Qendra Kombëtare e Biznesit	Marrëveshja për krijimin dhe menaxhimin e Portalit Rajonal të Regjistrave të Bizneseve të Evropës Juglindore.	BERZH	<i>Zbatimi i Veprimit të Reformës është në progres. BERZH ka shprehur gatishmërinë e saj për të mbështetur financiarisht bashkimin e të gjitha ekonomive të tjera rajonale me Marrëveshjen që fillimisht do të nënshkruhet nga SBR-A dhe CRRM.</i>
2.2 Krahasoni, rishikoni dhe përshtatni aty ku është e mundur kërkesat e regjistrimit të biznesit në nivel rajonal.	2.2.1 Lehtësoni një rishikim në nivel mbarë rajonal dhe krahasimin e kërkesave për regjistrimin e biznesit duke ndarë informacionin përkatës.	Qershor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Një raport përmbledhës që paraqet kërkesat e regjistrimit të biznesit për t’u krahasuar sipas rishikimit rajonal.	Nevojiten, nuk sigurohen (për hartimin e raportit) GBB- BB-PNI (për	<i>Një listë treguese e kërkesave për regjistrimin e biznesit që do të krahasohet sipas rishikimit rajonal përshihet në aneks. Mbështetja e WBG do të ofrohet për rishikimin rajonal.</i>



					rishikim rajonat)	
	2.2.2 Bazuar në Veprimin IRAP 2.1.1., konsideroni përfaqsimin e kërkesave për regjistrimin e biznesit dhe vendosni nëse do të bëni përpjekje të mëtejshme për reforma	Dhjetor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Vendimi për zbatimin e veprimeve reformuese.	Nuk nevojitet	<i>Pas vendimit, autoritetet shqiptare do të përditësojnë këtë seksion IRAP në përputhje me rrethanat dhe do të specifikojnë/përsbkruejnë më tej çdo përpjekje reformash që Qeveria synon të ndërmarë sipas veprimit IRAP 2.2.2.</i>
<i>2.3 Lehtësoni dhe përshejtoni procedurat e lejes së punës dhe të qëndrimit dhe procedurat përkatëse në nivel ekonomik.</i>	2.3.1 Krijoni një inventar të të dhënave ekzistuese, legjislacion dhe procedura operacionale dhe vlerësoni nevojën për lehtësimin dhe përshejtimin e procedurave aktuale	Qershor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë Ministria e Brendshme	Një inventar që përmban të dhënat ekzistuese, legjislacionin dhe procedurat operacionale. Një raport që vlerëson lejen aktuale të punës dhe procedurat e ndërlidhura, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim.	Nevojitet, jo e siguruar	
	2.3.2 Zhvilloni dhe zbatoni leje të reja pune dhe procedura përkatëse	Dhjetor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë Ministria e Brendshme	Leja e re e punës dhe procedurat e lidhura aty ku është e mundur, në bazë të raportit të krijuar përmes IRAP Veprimi 2.3.1.	Nuk nevojitet	



	2.3.3 Hartoni udhëzime procedurale	Qershor 2020	Ministria e Financës dhe Ekonomisë Ministria e Brendshme	Udhëzimet procedurale për të gjitha lejet e punës dhe procedurat e ndërlidhura.	Nevojitet, jo e siguruar	Udhëzimet duhet të përmbajnë detaje për gjithçka që nevojitet për tëshimin e lejeve të punës për të huajt, siç janë informacionet e nevojshme për aplikantin, dokumentacioni i kërkuar, procedurat dhe hapat e detajuara, përgjegjësitë, afatet, tarifat administrative dhe dispozita të tjera. Udhëzimi duhet të krijohet në përputhje me kërkesat e Veprimt të Reformës 2.1.1. dhe duhet të përshiben si të dbëna që do të ofrohen në atë Veprim Reformues.
--	------------------------------------	--------------	---	---	--------------------------	--

Zona e politikave II. Mbrojtja dhe ruajtja e investimeve

Çështja e reformës/ Angazhimi RIRA	Veprimet IRAP	Afati kohor	Agjencia drejtuese	Rezultatet	Mbështet je e donatorëve	Komente
3. Përafrimi i kornizave ligjore për investime, përfshirë MNI-të, me praktikat e mira ndërkombëtare dhe standardet e BE-së						
3.1 Kryeni një rishikim të hollësishëm dhe rishikim krahasues të thellë të marrëveshjeve ndërkombëtare të investimeve (MNI ²) WB6 ³ , me fokus të veçantë në TDI, duke i krahasuar ato me MNI-të e gjeneratës së re për të përmirësuar përjasjen me standardet e orientuara nga reformat në standardet e gjeneratës së re MNI/BE ³ .	3.1.1 Kryeni një rishikim të hollësishëm dhe gjithëpërfshirëse të MNI-ve aktualisht në fuqi në Shqipëri	Qershor 2019	Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme(Asistues e)		GBB- BB-PNI	Objekti i analizës përshkruhet në Aneks Raporti do të përafrohet dhe do të mbështetet në një analizë të kryer nga GIZ (Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar) që është në progres.
	3.1.2. Kryeni një analizë krahasuese të MNI-ve të Shqipërisë me ato të ekonomive të tjera të WB6.	Shtator 2019	Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (Asistuese)	Një raport i sintezës i bazuar në Veprimin IRAP 3.1.1, duke krahasuar MNI-të me ekonomitë e tjera të ekonomisë WB6.	GBB- BB-PNI	



	3.1. 3. Standardizimi i MNI të Shqipërisë me standardet e gjeneratës së re MNI dhe BE (CETA, UNCTAD IPFSD) për të identifikuar boshllëqet dhe për të zhvilluar rekomandime për të përmirësuar përputhjen me standardet e orientuara nga reforma në standardet e gjeneratës së re MNI/BE	Shtator 2019	Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (Asistues e)	Raportoni bazuar në rezultatin nga Veprimi 3.1.1 IRAP. Një shënim i shkurtër mbi efektin e pranimit të BE në MNI-të ekzistuese.	GBB- BB-PNI	<i>Standardizimi i MNI-ve me standardet e reja të gjenerimit MNI dhe BE do të përafrohet ngushtë me Kornizën e Politikave të Investimeve të UNCTAD për Zhvillimin e Qëndrueshëm (IPFSD). Një shembull i një gjenerate të re MNI është shumica e Kapitullit të Investimeve të Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse Ekonomike dhe Tregtare midis Bashkimit Evropian dhe Kanadasë (CETA), i cili gjithashtu shërben si një përfaqësim i standardeve aktuale të BE-së (por duke përjashtuar mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të CETA-s).</i>
3.2 Kryeni një analizë boshllëku/ mospërputhjeje të legjislacioneve specifike të investimeve të brendshme të ekonomive me MNI-të e tyre dhe gjenerata e re MNI, bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të kornizave të investimeve ligjore të ekonomive që do të kryhen pas miratimit të agjendës rajonale të reformës së investimeve.	3.2.1. Kryeni një analizë gjithëpërfshirëse të kuadrit ligjor të brendshëm të Shqipërisë për mbrojtjen e investimeve dhe analizoni boshllëqet përballë MNI-ve të ekonomisë si dhe gjeneratës së re MNI	Qershor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Një raport i veçantë për ekonominë që rishikon kuadrin ligjor vendas të Shqipërisë për mbrojtjen e investimeve dhe krahasimin e tij përballë MNI-të e ekonomisë dhe me MNI-të e gjeneratës së re	GBB- BB-PNI	<i>Objekti i analizës përshkruhet në Aneks. Analiza do të mbështetë përpjekjet e vazhdueshme të reformës për hartimin e “Ligjit të Unifikuar të Investimeve”.</i>
3.3 Përmirësimi i legjislacioneve të brendshme në përputhje me standardet e parashikuara në MNI të gjeneratës së re.	3.3.1 Zbatoni “Ligjin e Unifikuar të Investimeve”	Dhjetor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	“Ligji i Unifikuar i Investimeve” i miratuar.	Nuk nevojitet	

traktate, ose dypalëshe, ose në marrëveshje rajonale ose multilaterale. Disa traktate merren vetëm me investime të huaja (zakonisht të referuara si traktate dypalëshe të investimeve ose “TDI”). Të tjerët trajtojnë investime së bashku me çështje të tjera të lidhura, siç janë tregtia, prokurimi nga qeveria, konkurrenca dhe pronësia intelektuale (marrëveshjet preferenciale ose të tregtisë së lirë, ose “MPT”). Për më tepër, ekzistojnë disa traktate shumëpalëshe që ofrojnë mbrojtje të veçantë në sektorin e energjisë (“Traktati i Kartës së Energjisë”) ose që sigurojnë akses në organe të posaçme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (Marrëveshja e ICSID). Më tej, instrumente të shumta ligjore, duke përfshirë për shembull traktatet e tatimit të dyfishtë (TTD)

³ Marrëveshja CEFTA nuk do të preket nga ky veprim i reformës.



3.4 Forcimi i mandatit të Grupit të Përbashkët të Punës SEEIC-CEFTA mbi Investimet për ta krijuar atë si një mekanizëm për shkëmbimin rajonal të standardeve MNI, modernizimin e MNI-ve dhe, nëse konsiderohet e nevojshme nga ekonomitë pjesëmarrëse, për të mundësuar zhvillimin e një qasjeje strategjike për negocimin/ rishikimin e MNI.	3.4.1. Mbështesni këtë shkëmbim rajonal duke emëruar përfaqësuesit në baza rast pas rasti sipas temave teknike të Grupit të Përbashkët të Punës mbi Investimet për Grupin Teknik të Nën - Punës.	Në vazhdim	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Emërimet e përfaqësuesve në bazë rast pas rasti sipas temave të grupit të posaçëm teknik të nënpunës.	RCC, GBB- BB-PNI	Dialogu rajonal i orientuar drejt politikave mbi marrëveshjet e investimeve ekziston tashmë në kuadër të Komitetit të Investimeve të Evropës Juglindore dhe kjo strukturë ekzistuese do të përdoret për qëllimet e kësaj pike të veprimit
4. Forcimi i mekanizmave të ruajtjes së investimeve në rajon						
4.1 Përmirësoni mekanizmat e krijuara të ankesave të investitorëve në ekonomitë e interesuara, duke marrë parasysh nivelet e ndryshme të zhvillimit dhe mbështetjen e nevojshme për ndërtimin e kapaciteteve.	4.1.1. Kryeni diagnostika në menaxhimin e ankesave të investitorëve në Shqipëri	Qershor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Një raport diagnostik mbi menaxhimin e ankesave në Shqipëri, përfshirë rekomandimet për hartimin e një mekanizmi të ankesave.	GBB- BB-PNI/BER ZH	Objekti i diagnostikimit përshkruhet në Aneks
	4.1.2. Hartoni dhe zbatoni një strukturë të përshtatshme institucionale për menaxhimin e ankesave	Dhjetor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Hartoni një mekanizmi të ankesave, bazuar në raportin diagnostik të Veprimit të Reformës 4.1.1. dhe të vërtetuara përmes konsultimeve të sektorit publik dhe privat. Një manual operativ dhe udhëzime	GBB- BB-PNI/BER ZH	Zbatimi i Veprimit të Reformimit është në progres. Një draft aktual i "Ligjit të Unifikuar të Investimeve" krijon një mekanizëm të ankesave nën Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrësit. Diagnostikimi sipas Veprimit IRAP 4.1.1. projektobet për të informuar mbi hartimin e mekanizmit të ankesave.



				operative për mekanizmin e ankesave. Zbatimi i mekanizmit të ankesave, përfshirë reformat rregullatorë (nëse nevojitet). Informacion mbi mekanizmat e ankesave të shpërndara dhe të ndara me sektorin privat dhe agjencitë publike federale dhe nënkombëtare.		
	4.1.3. Hartoni dhe zbatoni një mjet ndjekës për të trajtuar ankesat e investitorëve, investimet e ndikuara dhe informacionet e lidhura me to	Dhjetor 2019	Ministri i Shtetit për Sipërmarrësit	Dizajn për mjetin e ndjekës (zgjidhja teknike dhe baza institucionale). Një manual operativ për përdorimin e mjetit ndjekës. Mjet i ndjekës dhe drejtimit. Raportet vjetore që përshkruajnë rezultatet e ankesave, që do të përdoren për mbështetjen e politikave.	GBB- BB-PNI/BER ZH	<i>Mjeti i ndjekës mund të jetë në një format të thjeshtë excel, i cili është më i lehtë dhe më pak i kushtueshëm për t'u instaluar, ose në formën e softuerit më të sofistikuar.</i>



	4.1.4. Ndërtoni kapacitete mbi menaxhimin e ankesave, MNI, mbledhjen e të dhënave, dhe monitorimin dhe vlerësimin	Dhjetor 2019	Ministri i Shtetit për Sipërmarrësit	Një numër seminaresh me zyrtarë të agjencisë përkatëse.	GBB- BB-PNI/BER ZH	
<i>4.2 Forcimi i mandatit të Grupit të Përbashkët të Punës mbi Investimet SEEIC-CEFTA për ta krijuar atë si një platformë rajonale për shkëmbimin e përvojave në menaxhimin e ankesave dhe parandalimin e mosmarrëveshjeve për investime.</i>	4.2.1. Mbështesni këtë shkëmbim rajonal duke emëruar përfaqësuesit në baza rast pas rasti në bazë të temave teknike të Grupit të Përbashkët të Punës për Investimet për grupin teknik të nënpunës.	Në vazhdim	Ministri i Shtetit për Sipërmarrësit	Emërimet e përfaqësuesve në baza rast pas rasti sipas temave të grupit të posaçëm teknik të nënpunës.	RCC, GBB- BB-PNI	

Zona e politikave III. Tërheqje dhe nxitje e investimeve⁴

⁴ Mundësitë për t'u lidhur me financimin WBIF (EIF) do të eksploroohen për veprimet e reformës mbi nxitjen e investimit ku është e mundur dhe e përshtatshme.



Çështja e reformës/ Angazhimi RIRA	Veprimi IRAP	Afati kohor	Agjencia drejtuese	Rezultati	Mbështetje e Donatorëve	Komente
<i>5. Zhvillimi i një iniciative për nxitjen e investimeve rajonale</i>						
<i>5.1 Krijoni një kuadër rajonal për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet ndërmjetësve individualë të nxitjes së investimeve të ekonomisë (IPI) ose agjencive (IPA), duke pasur parasysh mundësinë e krijimit të një njësie koordinimi brenda strukturave ekzistuese rajonale</i>	5.1.1. Formalizoni kuadrin rajonal për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit brenda strukturave ekzistuese dhe emërimin e stafit të duhur të nivelit teknik nga AIDA për të përfaqësuar Shqipërinë në nëngrupin e punës.	Dhjetor 2018	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)	Emërimet e përfaqësuesit kryesor (dhe alternati).	Nuk nevojitet	<i>Grupi teknik i nënpunës për nxitjen e investimeve tashmë ekziston në Komitetin e Investimeve të Evropës Juglindore dhe do të përdoret për këtë çështje veprimi. Përfaqësuesit kryesorë mund të zgjedhin/ dërgojnë përfaqësues të tjerë rast pas rasti sipas temave të dialogut rajonal për nxitjen e investimeve.</i>
	5.1.2. Propozoni një numër temash për diskutim në komitetin e grupit teknik të nënpunës dhe kontribuoni sipas nevojës për diskutimet dhe konsideratat për të lehtësuar funksionimin efektiv të grupit të punës.	2019-2020	AIDA	Minutat e takimeve dhe marrëveshjet e takimeve periodike.	RCC/WBG - WB IPP	<i>Aktivitet në vazhdim.</i>
<i>5.2 Mbështesni zhvillimin e një portali rajonal të investimeve për kërkesat rregullatore dhe mundësitë e investimeve në të gjithë rajonin që bazohet në portalet</i>	5.2.1. Organizoni një takim me Forumin e Dhomave të Investimeve (CIF) për të diskutuar mundësitë e mundshme për bashkëpunim të ardhshëm me forcimin e portalit të investimeve rajonale.	Mars 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë/AIDA	Marrëveshje me CIF lidhur me opsionet dhe modalitetet konkrete për bashkëpunim në portalin e investimeve rajonale.	RCC/WBG WB - IPP	<i>Qëndrueshmëria afatgjatë e platformës promovuese rajonale on-line është thelbësore.</i>



<i>ekzistuese rajonale të investimeve, siç është ajo e Forumit për Investime të Dhomave të BB-së dhe të tjerëve, ku shihet e përshtatshme.</i>	5.2.2. Krijoni një hapësirë në portalin aktual të investimeve rajonale CIF (www.investinEJL.com) për të pritur pilotin e nxitjes së sektorit rajonal (shikoni veprimin IRAP 5.4).	Qershor 2019	Ministria e Financës dhe Ekonomisë/AIDA	Faqja është përshtatur për të pritur projektin pilot rajonal për nxitjen e sektorit në portalin rajonal të investimeve CIF.	RCC/WBG WB - IPP	
	5.2.3. Përgatisni dhe siguroni të dhënat përkatëse relevante për projektin pilot të dakordësuar për nxitjen e sektorit rajonal për krijimin e një raporti ose profili të nxitjes së sektorit rajonal.	Dhjetor 2019	AIDA	Raporti dhe të dhënat përkatëse të ofruara për të ushqyer projektin pilot të nxitjes së sektorit rajonal.	Nuk nevojitet	<i>Aktiviteti duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur për të lejuar më shumë kohë për të vlerësuar ndikimin promovues të JIPI</i>
<i>5.3 Mbështetmi ndërmjetës individual të nxitjes së investimeve të ekonomisë për të kontribuar në mënyrë efektive në nismën e nxitjes së investimeve rajonale.</i>	5.3.1. Vlerësoni nevojat për ngritjen e kapaciteteve të brendshme në nxitjen e investimeve	Janar 2019	AIDA	Jepni një listë ose sugjeroni module për ngritjen e kapaciteteve për nxitjen e investimeve bazuar në nevojat për ngritjen e kapaciteteve për nxitjen e investimeve të brendshme.	Nuk nevojitet	<i>Lista do të përdoret si kontribut për zhvillimin e një analize rajonale për kërkesën për ndërtimin e kapaciteteve/trajnimeve, së bashku me informacionet e siguruar nga ekonomitë e tjera pjesëmarrëse nga rajoni. Bazuar në këtë vlerësim, një grup modulesh të mundshme trajnimi me interes të përbashkët do të përpilohet nga RCC me mbështetjen e projektit WBG-WB IPP. Identifikimi i ofruesve të përshtatshëm të trajnimit dhe zbatimi aktual i moduleve të trajnimit varen nga mundësia e financimeve.</i>
	5.3.2. Caktoni stafin përkatës të Agjencisë dhe/ose Ministrisë, të cilët duhet të marrin pjesë në modulet e propozuara për ndërtimin e kapaciteteve	Qershor 2019	AIDA dhe ministrinë e interesuara	Lista e stafit të hartuar, konfirmuar dhe dërguar.	Nuk nevojitet	<i>Nxitja e investimeve është një proces bashkëpunues dhe ministritë e përfshira në procesin për nxitjen e investimeve më të gjera duhet të marrin në konsideratë seriozisht pjesëmarrjen në trajnime për të përmirësuar koordinimin e nxitjes së investimeve. Ministrinë që dëshirojnë të marrin pjesë në trajnim duhet të marrin parasysh të dërgojnë pikën fokale të ministrisë për çështjet që kanë të bëjnë me investimet dhe/ose të punojnë me AIDA.</i>



	5.3.3. Agjencia e zgjedhur dhe/ose stafi i Ministrisë ndjekin modulet për ngritjen e kapaciteteve për nxitjen e investimeve	2019 - 2020	Ministritë e interesuara dhe/ose AIDA	Fletat e vlerësimit të trajnimit dhe draftet e përzgjedhura të dorëzuara	RCC, GBB-BB-PNI	<i>Trajnimit do të përpigjen të sigurojnë një draft specifik të arritshëm në mënyrë që trajnimit të rezultojnë në një program pune dhe/ose udhëzime konkrete dhe të zbatueshme. Kohëzgjatja e zgjeruar bazohet në tabelën e implementimit të seminareve të përzgjedhura të trajnimit.</i>
<i>5.4 Kryeni një analizë të thelluar të sektorit për të identifikuar sektorët dhe propozimet e vlerës për nxitjen e investimeve rajonale, me lidhje të qarta horizontale në shtyllën e MAP REA mbi specializimin e zgjuar.</i>	5.4.1. Zgjidhni dhe/ose propozoni 3 sektorë për nxitjen e investimeve rajonale bazuar në prioritetet e sektorit të ekonomisë.	Qershor 2019	AIDA dhe ministritë e interesuara	Sektorët prioritar për nxitjen rajonal të propozuar.	Për t'u përcaktuar	
	5.4.2. Diskutoni dhe bini dakord për një sektor pilot që do të jetë prioritet për nxitjen rajonal përmes platformës të formalizuar sipas 5.1.	Shtator 2019	AIDA dhe ministritë e interesuara	Marrëveshja dhe vendimi për sektorin për projektin pilot rajonal për nxitjen e investimeve.	Nuk nevojitet	
	5.4.3. Diskutoni dhe bini dakord mbi formatin (p.sh. PPT, hartë dhe/ose sektorin rajonal, shkurtimisht ...) të propozimit të vlerës dhe të dhënave mbështetëse për sektorin e përzgjedhur për projektin pilot rajonal të nxitjes së investimeve përmes platformës së formalizuar sipas 5.1.	Shtator 2019	AIDA	Marrëveshja përfundimtare dhe përzgjedhja e formatit/formateve për zhvillimin e propozimit të vlerës dhe materialeve promovuese dhe përmbajtjes për sektorin e përzgjedhur për projektin pilot rajonal të nxitjes së investimeve.	Nuk nevojitet	
	5.4.4. Mbështesni krijimin e një sistemi bazë M & V për projektin pilot rajonal të nxitjes së investimeve	Shtator 2019	AIDA	Sistemi i M & E themelor dhe i thjeshtë i krijuar (d.m.th. Numri i hiteve në internet, numri i pyetjeve ...).	RCC/GBB-BB-PNI	<i>Dialogu rajonal do të mbajë rezultatet periodike të M & E, megjithatë vlerësimet aktuale mund të kryhen edhe nga një palë e jashtme.</i>



	5.4.5. Vlerësoni rezultatet e projektit pilot rajonal për nxitjen e investimeve dhe vendosni nëse do të zgjeroni projektin pilot në sektorë të tjerë.	Shtator 2020	AIDA	Vendimi për vazhdimin, zgjerimin ose përfundimin e projektit pilot rajonal për nxitjen e investimeve.	Nuk nevojitet	
<i>6. Incentivat e dubura dhe përmirësimi i transparencës dhe qeverisjes së tyre</i>						
<i>6.1 Zbatimi i standardeve dhe parimeve të nxitjes në lidhje me transparencën, qeverisjen dhe parashikueshmërinë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i para anëtarësimit në BE (kapitulli mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore).</i>	6.1.1 Përmirësimi i transparencës në incentivat e ndihmës shtetërore	Qershor 2019	Komisioni i Ndihmës Shtetërore	Inventar gjithëpërfshirës i skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore. Harta e ndihmës shtetërore rajonale përfundoi.	Nuk nevojitet	<i>Inventari i ndihmës shtetërore duhet të jetë një bazë të dhënash e kërkueshme me informacion mbi hartimin e çdo mase të ndihmës shtetërore, identitetin e përfituesve individualë dhe ndihmën shtetërore të dhënë, kur ky i fundit tejkalon pragun minimal. Harta duhet të identifikojë zonat gjeografike ku kompanitë mund të marrin ndihmë shtetërore dhe nivelet e ndihmës në dispozicion.</i>
	6.1.2 Forcimi i raportimit dhe rishikimit të ndihmës shtetërore	Dhjetor 2019	Komisioni i Ndihmës Shtetërore	Rritja e kapacitetit zbatues të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe rritja e mbajtjes së shënimeve.		
	6.1.3 Ndarja e informacionit mbi incentivat e ndihmës shtetërore përmes portalit të investimeve rajonale	Dhjetor 2019	Komisioni i Ndihmës Shtetërore	Informacion mbi vendimet e ndihmës shtetërore, hartën rajonale etj., të ndara në portalin e investimeve rajonale (www.investinsee.com) së bashku me inventarin e incentivave ose sigurimi i një lidhje me informacionin përkatës	Nuk nevojitet	



	6.1.4 Harmonizimi i praktikave dhe ligjeve me standardet dhe politikat e BE-së për ndihmën shtetërore.	Dhjetor 2019	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Legjislacioni kombëtar i harmonizuar me legjislacionin e BE-së mbi kontrollin e ndihmës shtetërore.	Nuk nevojitet	
6.2 Përmirësimi i aksesit në informacion mbi incentivat duke publikuar inventarët e nivelit ekonomik që centralizojnë dispozitat kryesore dhe të dhënat që lidhen me këto instrumente.	6.2.1 Kryeni një rishikim të detajuar të incentivave në dispozicion në të gjitha nivelet e qeverisë dhe hartoni një inventar gjithëpërfshirës dhe të përditësuar të incentivave për Shqipërinë	Shtator 2019	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Inventari i incentivave të investimeve, përfshirë masat e ndihmës shtetërore të konsoliduara në një inventar të vetëm.	Nuk nevojitet	<i>Inventari duhet të synojë të përfshijë:</i> • Renditjen e sektorit të aplikueshëm • Kriteret e përshtatshmërisë për përfitimin nga incentivat • Procedurat për të marrë incentiva (dokumentet që duhet të plotësohen, regjistrimi i biznesit, certifikatat për të marrë etj.) • Lidhje me ligjin përkatës • Identifikimi i agjencisë zbatuese dhe informacioneve të kontaktit
	6.2.2 Vleftësoni inventarin me palët e interesuara dhe publikoni në format të mirë kuptueshëm	Dhjetor 2019	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Inventari i kompletuar dhe i vërtetuar i incentivave publikohet në një faqe të vetme interneti, gazetë zyrtare ose publikime të tjera përkatëse të ministrisë. Inventari ndahet (publikohet) në portalin CIF.	Nuk nevojitet	<i>Inventari duhet të publikohet në gjuhën shqipe, angleze dhe të tjera gjuhë përkatëse, sipas zgjedhjes të qeverisë.</i>
	6.2.3 Institucionalizimi i procesit të mbajtjes së inventarit publik të incentivave	Qershor 2020	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Përditësimi i inventarit të incentivave institucionalizohet nëpërmjet aktit të qeverisë.	Nuk nevojitet	<i>Rezultati do të përfshinte mbajtjen e inventarit në baza të rregullta siç përcaktohet dhe konsiderohet e përshtatshme nga qeveria.</i>



6.3 Angazhimi në të mësuarit ndërmjet kolegëve mbi metodologjitë për vlerësimin e koston dhe përfitimit dhe përvojat mbi qeverisjen dhe administrimin e incentivave në kontekstin e Grupit të Përbashkët të Punës mbi Investimet EJLIC-CEFTA.	6.3.1 Mbështetja për angazhimin rajonal ndërmjet kolegëve nëpërmjet formimit të një grupi teknik kombëtar nëpunë si pjesë e Grupit të Përbashkët të Punës mbi Investimet (JWGI) të EJLIC-CEFTA-s.	Qershor2019	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Përfaqësuesit e duhur të emëruar rast pas rasti sipas temave të grupit specifik teknik të nëpunës.	Nuk nevojitet	JWGI do të punojë për të harmonizuar prioritetet e MAP REA me ato të përcaktuara nga Strategjia për Evropën Juglindore 2020 dhe CEFTA. Të emëruarit duhet të jenë nga ministrat/agjencitë që janë përfaqësuese të fushave teknike (në këtë rast inventivat).
	6.3.2 Përdorni portalin e investimeve rajonale si një mjet për të lehtësuar të nxënit peer-to-peer dhe shkëmbimin e praktikave më të mira.	Qershor2020	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Raportet e rregullta rajonale ndahen përmes portalit të investimeve rajonale (www.investinEJL.com)	Nuk nevojitet	Informacioni mund të përfshijë metoda për monitorimin dhe vlerësimin, analizën kosto-përfitim, zbatimin e praktikave të mira ndërkombëtare, materialet e trajnimit, anketat e motivimit të investitorëve etj.
	6.3.3 Vlerësimi i nevojave për trajnim në lidhje me hartimin dhe administrimin e incentivave dhe praktikave të mira, si dhe marrja pjesë në programe trajnimi, workshope, seminare etj., të cilat konsiderohen të dobishme.	Qershor2019	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Është përgatitur lista e programeve të nevojshme për ndërtimin e kapaciteteve që mund të bëhen në baza rajonale.	Nuk nevojitet	Lista do të përdoret si kontribut për zhvillimin e një analize të kërkesës për ndërtimin e kapaciteteve/trajnimeve rajonale, së bashku me informacionet e siguruar nga ekonomitë e tjera pjesëmarrëse nga rajoni. Bazuar në këtë vlerësim, një grup modulesh të mundshme të trajnimit me interes të përbashkët do të përpilohet nga RCC me mbështetjen e projektit WBG-WB IPP. Identifikimi i ofruesve të përshtatshëm të trajnimit dhe zbatimi aktual i moduleve të trajnimit varet nga mundësia e financimit.
6.4 Angazhimi sistematikisht në monitorimin dhe vlerësimin e incentivave për të vlerësuar efektivitetin dhe konsideratat kosto-përfitim në nivel ekonomie.	6.4.1 Forcimi i monitorimit dhe vlerësimit të ndihmës shtetërore	Qershor2019	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	Përmirësim i pavarësisë operative të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.	Nuk nevojitet	
	6.4.2 Zbatimi i metodave të monitorimit dhe vlerësimit për të gjitha programet e incentivave për të siguruar që incentivat përmbushin	Dhjetor2019	Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Departamenti i Politikave	Kriteret e specifikuar të përshtatshmërisë për të gjitha programet e incentivave Lidhje të qarta të krijuara	Nevojitet, nuk është siguruar	



	qëllimet e tyre dhe shërbejnë si përfitim për ekonominë		Fiskale)	midis programeve nxitëse dhe objektivave specifike të politikave. Zbatimi i një sistemi të përshtatshëm monitorimi dhe vlerësimi për çdo incentivë. Mbledhja e të dhënave të nevojshme për të lejuar një vlerësim të besueshëm Publikimi i rezultateve në gazetën zyrtare ose publikime të tjera përkatëse të ministrisë.		
	6.4.3 Angazhimi në programet e incentivave të analizës kosto-përfitim mbi një bazë të vazhdueshme për të informuar vendimet e politikave mbi programin dhe dizajnin e incentivave	Dhjetor 2019	Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Departamenti i Politikave Fiskale)	Miratimi i një metodologjie të përshtatshme për të vlerësuar në mënyrë efektive kostot e shpenzimeve të incentivave kundrejt përfitimeve të lidhura.	Nevojitet, nuk është siguruar	<i>Duhet të trajtohen shpenzimet tatimore dhe shpenzimet e tjera për çdo program të incentivave; të dhënat e mbledhura duhet të përdoren për të analizuar kthimet e investimeve; rezultatet duhet të vihen në dispozicion të qeverisë.</i>



SHTOJCË PËRSHKRIMI SHITESË I VEPRIMEVE TË ZGJEDHURA IRAP

Veprimi IRAP 1.1.2

Analiza e mospërputhshmërisë të hyrjes do të përfshijë shqyrtimin tërësor të ligjeve dhe rregulloreve të brendshme për kufizimet ligjore mbi hyrjen dhe krijimin e investimeve të huaja direkte. Ushtrimi kontribuon në disa objektiva:

1. Rrit transparencën për investorët e huaj duke thjeshtuar aksesin në informacion: një inventar i përditësuar i pengesave ligjore të hyrjes do të sigurojë një burim ku renditen kufizimet për investorët e huaj. Kjo lehtëson procesin e vendimmarrjes së investorëve të mundshëm dhe të investorëve ekzistues që dëshirojnë të shtrijnë projektet e tyre.

2. Siguron qartësi në nivelin aktual të kufizimit dhe formulimit të politikave të ndihmës: një vlerësim i ligjeve dhe rregulloreve të brendshme u mundëson qeverive të marrin në konsideratë të gjitha pengesat e ndryshme ligjore hyrëse që ekzistojnë për investorët, gjë që lehtëson kryerjen e një analize nëse niveli aktual i kufizimit pasqyron siç duhet qëndrimin e dëshiruar të politikave dhe ofron një bazë për reformat e mundshme.

3. Ofron udhëzime për hartimin e shtojcave për MNI-të e ardhshme që listojnë masa jo të përshtatshme (NCMs, shikoni më poshtë)⁵.

4. Lehtëson procesin e pranimit në BE: Duke pasur një listë gjithëpërfshirëse të pengesave hyrëse ligjore ndihmon për t'u lidhur me kapitullin 3 të *acquis communautaire* të BE-së (shikoni më poshtë) dhe përfundimisht për të përmbushur kriteret e pranimit.

5. Mund të përdoret për negociatat e OBT-së të Listës së Shërbimeve të Angazhimeve sipas Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS), posaçërisht për tregtimin e shërbimeve mode 3 (prania tregtare)⁶.

⁵ MNI që përdorin një përjasje të listës negative zakonisht përfshijnë, në aneks, një listë të të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që përbëjnë pengesa për investorët e huaj të cilët nuk janë në përputhje me angazhimet e përgjithshme të MNI, të cilat quhen masa të papërshtatshme. Ekonomitë, si: SHBA-ja, Kanadaja apo Japonia përdorin një qasje të listave negative në MNI-të e tyre, gjë që kërkon krijimin e një plani NCM.

⁶ Tregtia e Shërbimeve Mode 3 mbulon shërbimet e ofruara nga një ofrues i shërbimeve të një anëtarit të OBT-

Objekti thelbësor i analizës

Objekti thelbësor i analizës përfshin parimet e mëposhtme:

- Jodiskriminimi⁷: duke siguruar që asnjë ekonomi, nëpërmjet ligjeve ose rregulloreve të brendshme, të mos diskriminojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në favor të investorëve të vet ose në favor të një ekonomie të huaj mbi ekonomitë e tjera të huaja⁸;

- kërkesat e performancës: përcaktimi se asnjë ekonomi nuk do të kërkojë që investorët e huaj të përmbushin disa qëllime të caktuara në lidhje me veprimet e tyre në ekonominë pritëse;

- aksesin në treg: duke siguruar që asnjë ekonomi nuk mund të vendosë kufizime sasiore jodiskriminuese për pranimin dhe krijimin e investorëve të huaj; p.sh.

- Ndalimi i investimeve të huaja në sektorë të caktuar

- kërkesat minimale të kapitalit;

- kufijtë e kapitalit të huaj;

- niveli i lartë drejtues/bordi i drejtorëve: me kusht që investorët e huaj kanë të drejtë të angazhojnë personelin e lartë drejtues sipas zgjedhjes së tyre, pavarësisht nga kombësia.

